

MEHMET DERALLA, SINONIM I NDËRGJEGJES  
PATRIOTIKE

SHQIPTAR

Stephen (Edward) HARDY

UDK: 323.85(496.5)"18" 341.232(73:496.5)"18-"

**Abstrakt**

Historia e popullit shqiptar që nga themelimi i shtetit modern shqiptar në vitin 1912, është një histori shumë prekëse për familjet shqiptare. Të gjitha familjet shqiptare vuajtën atëherë, sikur që vuajnë edhe sot. Tregimet e tyre janë të mbushura përplot vështirësi ekonomike, privime nga arsimimi dhe izolim politik. Ata gjithmonë janë mbajtur në varfëri, iu është mohuar mundësia e arsimimit në gjuhën e tyre amtare dhe janë trajtuar si qytetarë të rendit të tretë në territoret ku ata kanë jetuar për shumë shekuj.

Ky shkrim tregon historinë e familjes Deralla nga Tetova. Njëjtë sikur fqinjët e tyre, ashtu edhe familja Deralla, ka paguar një çmim shumë të lartë, për shkak të gjakut që rrjedh në venat e tyre. Po ashtu, njëjtë sikur fqinjët e tyre, kjo familje luftoi kundër fuqive autoritare, të cilat u përpoqën ta eliminojnë atë.

Përgjatë gjithë kësaj historie ka një gjë që vazhdimisht është e qëndrueshme: tema përsëritëse e shtypjes. Që nga koha e Mbretërisë së Jugosllavisë e deri në kohën e komunizmit të Titos, edhe më pas, deri në një sistem jofunksional që sot quhet FYROM, të gjithë këto miratuan si politikë shtetërore shtypjen e qytetarëve të tyre shqiptarë.

**Fjalë kyçe:** familja Deralla, akademi ushtarake, oficer, arratisja në Amerikë.

Në më shumë se 100 vjet nga themelimi i shtetit modern shqiptar, kemi qenë dëshmitarë të shumë ndodhive të jashtëzakonshme, si të mëdha ashtu edhe të vogla. Historia ka vëzhguar tentimin shkurtpamës dhe grabitqar të shteteve ballkanike, për të gdhendur territoret shqiptare në shërbim të zgjerimit të tyre. Historia ka parë se si breza të tërë të patriotëve shqiptarë, burra e gra, kanë luftuar për kauzën e lirisë. Nga ana tjetër, pasardhësit kanë parë kur presidentët amerikanë disa herë me radhë kanë ndërhyrë në llogari të popullit shqiptar, edhe atë jo për interesa të tyre, por thjeshtë në shenjë miqësie.

Ne jemi mbledhur këtu për të diskutuar lidhur me këto ngjarje. Kemi shkruar dhe fjalët tona mbajnë një përgjegjësi të madhe, për të lënë të kuptohet se është me rëndësi të kujtohen dhe bisedohen ndodhitë, të cilat na kanë sjellë të jemi bashkë këtu. Dëshiroj të shpreh nderimet e mia ndaj popullit shqiptar, i cili ka sakrifikuar aq shumë në këto 100 vjetët e kaluar.

Etërit dhe nënat tuaja, gjyshërit dhe stërgjyshërit tuaj, kontribuuan nga vullneti i tyre i lirë që sot të mund të takohemi këtu afër Tetovës, hapur, pa mos pasur frikë se mund të arrestohemi. Tetova, si një qytet krenar, është shtëpia e dy universiteteve shqiptare. Le të kujtojmë se vetëm pak vite më parë ishte kundër ligjore të studiohej në gjuhën shqipe. Pra, le të duartrokasim dhe shprehim mirënjohje për ata patriotë, të cilët erdhën para nesh dhe shfaqën krenari për atë që kanë arritur. Fryti nga pema e vjetër është me të vërtetë i ëmbël.

Në veçanti dëshiroj të flas për një familje, rrënjët e së cilës janë të thella në ndërgjegjen shqiptare. Familja e Mehmet Pashë Derallës ishte e përqendruar në Tetovë për shumë breza me radhë. Në vitin 1912, në qytetin e Vlorës, ai u zgjodh ministër i Luftës i shtetit sapo të krijuar shqiptar. Ai luftoi për të mbrojtur territoret shqiptare, përfshirë këtu edhe rajonin e Tetovës. I kapur nga serbët dhe i liruar në vitin 1917, Pashë Deralla u kthye në Tetovën e tij të dashur, ku edhe vdiq në vitin 1918.

Djali i Pashë Derallës, Gajur Deralla është rritur në pronat e Derallajve në Tetovë. Pasi përfundoi Akademinë Ushtarake në Vinkovc, Gajuri u bë oficer në Armatën Shqiptare. Shumë shpejt, familjen Deralla do ta kaplojë sërish lufta. Në vitin 1939, Italia okupoi Shqipërinë, kurse Gajuri me gradën e majorit, luftoi italianët. Ai u zu dhe u burgos në Afrikën e Jugut dhe më pas u lëshua dhe u kthye në Tetovë. Në vitin 1941 organizoi batalionin “Luboten”, me vullnetarë shqiptarë, si pjesë e Lëvizjes patriotike kombëtare, për të luftuar për lirinë e shqiptarëve kundër partizanëve komunist në këtë rajon.

Pas arrestimit nga gjermanët në vitin 1944, majori Gajur Deralla i shpëtoi një skuadre të pushkatimit dhe u kthye në Tetovë. Me mposhtjen e fashizmit, në vitin 1945, territoret shqiptare ranë nën kontrollin e një kërcënimi të ri nga partizanët komunist. Në të vërtetë, familja Deralla vuajti sikur edhe shumë familje të tjera shqiptare nën duart e komunistëve. Majori Deralla u arrestua dhe u burgos në Maqedoni, por komunistët ishin edhe më mizorë ndaj familjes së tij.

Në vitin 1946, autoritetet jugosllave mbërritën tek shtëpia e familjes Derralla, duke u dhanë grave dhe fëmijëve vetëm 15 minuta që të “zhduken”. Ata u vendosën në një kamion dhe u dërguan në kufirin me Shqipërinë, prej nga kaluan në anën tjetër, në Shqipëri. Me këtë rast, e gjithë prona e familjes Deralla ishte konfiskuar nga shteti jugosllav.

Në vitin 1949, Gajur Deralla iku nga burgu dhe për rreth 18 muaj u fsheh në rajonin e Pollogut. Gjatë kësaj kohe, ai takoi Ajshen, një femër shqiptare që e kishte njohur para lufte. Ajshja dhe Gajuri, gjatë gjithë kohës, u fshehën nga autoritetet jugosllave dhe arritën të sjellin në jetë një fëmijë para se Gajuri të arrestohej sërish. Ky djalë, Berati, u lind në vitin 1951, përderisa i ati i tij ishte burgosur padrejtësisht, si një “armik i popullit”. Ajshja dhe Berati jetuan në Shkup gjatë 20 vjetëve të ardhshme, ndërsa Gajuri qe liruar dhe sërish i arrestuar, disa herë me radhë për krimin e të qenit një patriot shqiptar.

Berati qysh si i ri ishte mbështetës i gjakut të tij dhe vuante për besimet e tij të “rrezikshme”. Në vitin 1970, Berati mbaroi me sukses vitin e parë në Universitetin e Shkupit. Një vit më vonë atij iu ndalua të regjistrojë vitin e dytë. Dekani i fakultetit do t’i thotë: “Përse dëshiron të regjistrohesh? Ti asnjëherë nuk do të diplomosh”.

Fatmirësisht, Gajurit dhe familjes së tij iu dha azil politik në Itali. Në vitin 1972, “Shoqëria për Shqipërinë e Lirë” në New York City rregulloi vizat për ta dhe ata u larguan për në Amerikë. Në një shoqëri të lirë dhe të hapur si SHBA-ja, familja Deralla më në fund ishin të lirë të shijojnë jetën. Mjerisht, majori Gajur Deralla vdiq në vitin 1974.

Sot Berat Deralla jeton në Tetovë dhe lufton të rikthejë atë që komunistët e vodhën nga familja e tij. Sidoqoftë, ai është tepër i vetëdijshëm se nuk mund t’i kthehet gjithçka nga prona e Derallajve familjes së tij, kjo do të ishte e pabesueshme. Mirëpo, ai me të drejtë shpreson që t’i kthehet diçka nga ajo që i është marrë nga pushteti familjes së tij. Unë dhe shumë miq të tij bashkëndejmë këtë gjë.

Ironia qëndron në atë se familja Deralla akoma vazhdon të jetojë, ndërsa Jugosllavia është e vdekur dhe varrosur tash e sa kohë. Ndoshta, kjo është një masë e drejtësisë.

## **Bibliografi**

Cox, Michael, and Doug Stokes. U.S. Foreign Policy. Oxford: Oxford University Press, 2008.

The Fourteen Points. United States History. 2014. <http://www.u-s-history.com/pages/h1324.html> (accessed June 24, 2014).

U.S Department of State: Office of the Historian . The End of the Cold War, 1981-1992. 2014. <https://history.state.gov/departmenthistory/short-history/endofcoldwar> (accessed June 22, 2014).

U.S. Department of State: Office of the Historian . The League of Nations, 1920. 2014. <https://history.state.gov/milestones/1914-1920/league> (accessed June 25, 2014).

Personal Interviews with Berat Deralla. Tetova: October - November, 2014.

# BASHKËPUNIMI I MEHMET PASHË DERALLËS ME KRERËT E KAZASË SË GJILANIT NË KRYENGRITJEN E VITIT 1912

Fitim RIFATI

UDK: 323.22(497.15:=18)''1912''

## Abstrakt

Gjilani me rrethinë në Kryengritjen e Përgjithshme Kundërosmane të vitit 1912, përkatësisht bashkëpunimi i krerëve të kësaj treve me Mehmet Pashë Derallën, është trajtuar në kuadër të zhvillimeve kryengritëse e politike në tërë Vilajetin e Kosovës, i cili jo vetëm që ishte qendër e atyre zhvillimeve, por edhe nxitës për shpërthimin e kësaj kryengritje edhe në kaza të Gjilanit dhe vise të tjera shqiptare. Prandaj në këtë studim ngjarjet kryesore, që e kanë karakterizuar Vilajetin e Kosovës, nuk ka qenë e mundur të anashkalohen në masë të madhe, ngase pa përfshirjen e tyre nuk do të mund të harmonizohej dhe paraqitej një përmbledhje më e plotë dhe argumentuese e kësaj teme hulumtuese-studimore. Situata politike që po e karakterizonte pjesën perëndimore të Vilajetit të Kosovës, reflektonte edhe në kaza të Gjilanit, që e bënte këtë kryengritje të zhvillohej e gërshetuar në binarët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në Vilajetin e Kosovës dhe përgjithësisht viset shqiptare të kohës. Siç dihet, në këtë kohë kazaja e Gjilanit përfshinte territoret e qyteteve të sotme të Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, disa pjesë të Prishtinës, Ferizajt, Kaçanikut e të Bujanocit, në përbërjen e së cilës shtriheshin më se 200 fshatra.

**Fjalët kyce:** Gjilani, Vilajeti i Kosovës, Mehmet Pashe Derralla

## Rrethina e Gjilanit në zgjedhjet e pranverës së vitit 1912

Popujt e Ballkanit që ishin akoma nën sundimin e Perandorisë Osmane shprehnin gjithnjë e më shumë pakënaqësi ndaj pushtetit xhonturk, i cili po përpiquej të bënte “ndryshime” për përmirësimin e situatës së brendshme në Perandori. Mirëpo, këto përpjekje nuk tregonin rezultate pozitive, por përkundrazi fuqizonin antagonizmat e popujve të Ballkanit, që reflektonin me përkeqësimin e raporteve ndërmjet tyre dhe xhonturqve. Në kuadër të kësaj situatë të përgjithshme, gjetën shprehje edhe zgjedhjet parlamentare të realizuara në pranverë të vitit 1912.

Pas shpërndarjes së Parlamentit (janar 1912) në pranverë u organizuan zgjedhje të reja në gjithë perandorinë. Këto zgjedhje u organizuan edhe në vilajetet shqiptare, ku një fushatë e ashpër u pa mes partisë “Bashkim e Përparim” kundër kandidatëve opozitarë. Ky proces zgjedhor përfshiu edhe kuzanë e Gjilanit. Lidhur me kandidimin për deputet në Parlamentin osman, kishte edhe serbë, që ishin futur në listën e kandidatëve xhonturq. Konsulli serb në Prishtinë, Millojeviq, njofton se përveç kandidatëve si Danish Beu, Hasan Prishtina e Ali Draga, edhe Sava Stojanoviç po angazhohej që të futej në mesin e kësaj gare, që sipas tij “myslimanët (shqiptarët, F. R.)” e Gjilanit “do ta pranojnë kandidimin e tij”.<sup>180</sup>

Meqenëse ligji për zgjedhjet vështirësonte në masë të madhe një proces të rregulltë zgjedhor dhe pa probleme, skenari i tyre ishte i qartë dhe tendencioz për të siguruar me çdo kusht fitoren e partisë xhonturke. Për këtë çështje komisioni zgjedhor kishte shpërndarë listat nëpër të gjitha fshatrat e kazasë së Gjilanit, të cilat ishin shkruar në gjuhën osmane dhe nuk kuptoheshin nga popullsia.<sup>181</sup> Prandaj, me qëllim që të fitonte sa më shumë kandidatë në Parlament, pushteti xhonturk përdorte forma të

---

<sup>180</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumente serbe* (në tekstin e mëtejshëm: *Dokumente serbe...*), Përgatitur nga Zekeria Cana, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008, f. 69.

<sup>181</sup> Aliriza Selmani, *Gjilani me rrethinë (1908-1912)*, Lidhja e Historianëve Shqiptar “Ali Hadri”, Prishtinë, 1998, f. 211.

ndryshme për të përçarë e mbjellur grindje midis opozitës, gjë të cilën e kishte arritur edhe në Gjilan.<sup>182</sup> Për këtë çështje në kazanë e Gjilanit, Preshevës e Prishtinës kishte shkuar edhe valiu i Kosovës Maz`har Beu. Ai kishte për qëllim të ndikonte në zgjedhësit që të votojnë për kandidatët e partisë xhonturke “Bashkim e Përparim”, mirëpo kundërshtimi për këtë parti, nga ana e shqiptarëve, ishte aq i madh, sa që Maz`har Beu i kishte shtyrë zgjedhjet të mbaheshin më 5 maj për t'i dhënë kohë zgjedhësve të mendojnë dhe binden për të votuar kandidatët e partisë xhonturke. Jo vetëm kaq, siç njofton konsulli francez P. Karlie më 26 prill 1912, valiu po vizitonte gati të gjitha fshatrat e këtyre anëve dhe për të arritur këtë qëllim dhe shtuar frikën ndaj shqiptarëve ai kishte marrë me vete shumë oficerë dhe nga dy kompani ushtarësh.<sup>183</sup> Në këtë periudhë ishin shtuar edhe lëvizjet ushtarake të forcave osmane në qytetet e Vilajetit të Kosovës<sup>184</sup> dhe do të qëndronin nëpër vendvotime deri në përfundim të zgjedhjeve dhe derisa situata të qetësohej sadopak.<sup>185</sup>

Kandidatë për deputet në Parlamentin osman nga sanxhaku i Prishtinës, pjesëtarë të opozitës shqiptare ishin ish-deputetët: Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Ali Danish Beu dhe Beqir Efendia. Ndërsa kandidatë qeveritarë, që nuk gëzonin atë popullaritet sikur ata të opozitës, ishin: Sudi efendia, kryetar i bashkisë së Prishtinës, Ymer efendia, i lindur në Stamboll dhe kushëri i Fuad Pashës, Hafuz Ymeri, hoxha nga Vushtrria dhe Dr. Dushan Çelîq. Shqiptarët ishin të interesuar që të zgjedhnin përfaqësuesit e tyre të denjë dhe për këtë çështje luftonin çdo padrejtësi që pushteti orvatej të realizonte në favor të kandidatëve të tij. Kështu, ngjarje të rëndësishme, lidhur me këtë çështje, ishin zhvilluar në Gjilan

---

<sup>182</sup> *Dokumente serbe...*, f. 144.

<sup>183</sup> *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, Vëllimi I (në tekstin e mëtejme: *Dokumente franceze I...*), zgjedhi, përgatiti dhe redaktoi Prof. dr. Muhamet Shatri, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2004, f. 113.

<sup>184</sup> Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë (në tekstin e mëtejme: AIHT), Vj-22-15-155, Raport i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme (në tekstin e mëtejme: MPJ) në Vjenë, 11 prill 1912.

<sup>185</sup> *Dokumente serbe...*, f. 147.

dhe rrethinën e tij. Raste si ai i fshatit Pogragjë, ku shqiptarët e dëbuan komisionin zgjedhor e në fshatin Shipashnicë, kur situata u tensionua dhe sa nuk shpërtheu një konflikt i armatosur ndërmjet burrave e grave shqiptare të atyshme, komisionit e ushtrisë, që edhe nga këtu u detyrua të dëbohej për në Gjilan, tregojnë për një proces jo të rregullt zgjedhor dhe me disa incidente jo të parëndësishme. Të përfshirë në ngjarjen e Shipashnicës ishin Sali aga nga Gjilani dhe Hamdi Novobërda, të cilët kishin shkuar atje për t'i bërë propagandë kandidatëve të opozitës. Ata, ndonëse u thirrën në konak nga valiu, nuk iu përgjigjën thirrjes së tij, por dolën në mal si opozitë e hapur dhe morën masat për organizimin e kryengritjes në këtë kaza. Autoritetet osmane kishin vendosur të kundërvepronin lidhur me këto ngjarje të fundit. Kështu, për në Gjilan ishte nisur “një tabor ushtrie nga Ferizaj dhe 50-60 ushtarë të kavalerisë” së Prishtinës dhe po organizoheshin roje ushtarake në të dy hyrjet e qytetit.<sup>186</sup>

Në ndërkohë, raste të tilla ishin shënuar edhe në fshatin Birivojcë, ku zgjedhjet ishin realizuar më 27 prill, ndërsa në fshatin Lubishtë kishte ndërhyrë ushtria për të qetësuar situatën pas një konflikti të popullsisë me pjesëtarët e komisionit zgjedhor, që si rezultat ishin plagosur dy shqiptarë të këtij fshati, ndërsa një ushtar ishte vrarë. Me këtë rast, Salih Aga i Lubishtës, një njeri me ndikim në këtë fshat, kishte ikur në mal së bashku me 10 shoqërues, ku formuan një çetë.<sup>187</sup> Kështu, numri i delegatëve për kazanë e Gjilanit ishte: 32 myslimanë (shqiptarë, F. R.) dhe 19 serbë. Pra, gjithsej 56 delegatë, ndërsa numri i votuesve ishte 34.488 votues.<sup>188</sup>

---

<sup>186</sup> AIHT, Vj-22-16-1648, Raport i zëvendëskonsullit austro-hungarez në Mitrovicë dërguar MPJ në Vjenë, 8 prill 1912; *Dokumente serbe...*, f. 155-156; *Dokumente italiane për Lëvizjen Kombëtare gjatë gjysmës së parë të vitit 1912*, hulumtuan, përzgjedhën dhe përgatitën: Prof. dr. Ramiz Abdylit dhe Prof. dr. Muhamet Shatri, Arkivi i Kosovës, “VJETAR”, nr. XXIX-XXX, Prishtinë, 2003, f. 261-262.

<sup>187</sup> AIHT, Vj-22-13-1358, Informacion i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar MPJ në Vjenë, 1 maj 1912; A. Selmani, *vep. e cit.*, f. 213.

<sup>188</sup> *Dokumente serbe...*, f. 150.

Për të arritur fitoren e xhonturqve, përveç kajmekamëve të Mitrovicës dhe Vushtrrisë, valiu kishte thirrur edhe kajmekamin e Gjilanit për t'u dhënë udhëzimet e nevojshme për zgjedhje.<sup>189</sup> Sipas konsullit serb në Prishtinë, Millojeviq, në Gjilan qeveria kishte 30 vota për kandidatët e saj, ndërsa opozita 24 vota.<sup>190</sup> Zgjedhja e delegatëve të Qeverisë për pushtetin osman kishte kaluar në një rezultat të disfavorshëm. Kështu kishte ngjarë edhe në Gjilan e rrethinë të tij. Sipas konsullit serb, Millojeviq, votimet e delegatëve në Gjilan ishin mbajtur më 30 prill. Për këtë proces ishin angazhuar përfaqësuesit e pushtetit nga sanxhaku i Prishtinës dhe kazaja e Gjilanit. Ndërsa Idriz Seferi, ditën e zgjedhjeve kishte shkuar në klubin xhonturk, e kishte sulmuar regjimin e qeverisë dhe, duke treguar dy patllaket në brez, kishte thënë se nuk do të lejonte që në Gjilan të sillen andej e këndej xhonturqit. Delegatët shqiptarë e kishin frikësuar mytesarifin dhe kajmekamin aq shumë sa ata ishin detyruar t'u lejojnë atyre të sillnin një shkronjë të veçantë për t'u plotësuar fletëvotimet, duke treguar kështu mosrespektimin e një procesi zgjedhor të rregullt. Gjatë numërimit të fletëvotimeve, ata vendosën rezultatin e votave në përputhje me interesat e tyre. Shkelje të tilla kishin ngjallur protesta në mesin e shqiptarëve.<sup>191</sup>

Pra, përmes përdorimit të një aparati të dhunshëm policor, përmes kërcënimeve dhe shantazheve, korrupsionit, burgosjes së përkrahësve të opozitës dhe aq më tepër duke përdorur edhe forcën e armëve, partia "Bashkim e Përparim" arriti të sigurojë shumicën e ulëseve në Parlamentin osman. Si rezultat i metodave të tilla arbitrare, kryengritja kundër administratës dhe pushtetit osman në viset shqiptare ishte e pashmangshme.<sup>192</sup>

---

<sup>189</sup> Po aty, f. 164.

<sup>190</sup> Po aty, f. 222.

<sup>191</sup> Po aty, f. 204.

<sup>192</sup> Zekeria Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912*, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 218.

## Përgatitjet për kryengritje në kazanë e Gjilanit

Në trevat e rrethinës së Gjilanit, që nga koha kur kryengritja e vitit 1910 ishte shuar nga ana e ushtrisë osmane, urrejtja dhe kujtimi mbi vrasjet dhe masakrat ndaj atdhetarëve shqiptarë në këto anë nuk ishte harruar. Idriz Seferi, ndër udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare në Gjilan dhe rrethinë, i kishte deklaruar peshkopit të dioqezës Shkup-Prizren në Shkup se pakënaqësia e tij dhe e popullit të anës së Karadakut kundër regjimit xhonturk kishte arritur kulmin, një kryengritje e re kundër këtij regjimi ishte e pashmangshme dhe se ai do të ishte ndër të parët e kësaj ane që do të rrokte armët dhe të luftonte sërish kundër këtij regjimi.<sup>193</sup>

Përgatitjet për këtë kryengritje po bëheshin që në vitin 1911,<sup>194</sup> ndërsa për këtë çështje Hasan Prishtina kishte pasur një takim edhe me konsullin austro-hungarez Kral në Selanik, më 5 janar 1912 gjatë kthimit të tij në Stamboll. Ai, në bisedë e sipër kishte folur rreth gjendjes aktuale me të cilën po përballeshin shqiptarët dhe se kishte vërejtur një unitet të tyre lidhur me pakënaqësinë që ata kishin me pushtetin xhonturk. Sipas tij, vetëm një kryengritje e shqiptarëve do të mund të shtrëngonte pushtetin xhonturk për përmirësimin e pozitës së shqiptarëve në Perandori. Hasan Prishtina kishte folur edhe për autonominë e Shqipërisë, mirëpo lidhur me këtë çështje ai kishte kërkuar edhe ndihmën e Austro-Hungarisë për mbështetjen e interesave të shqiptarëve. Ai ishte siguruar në ruajtjen e integritetit të Shqipërisë nga ana e konsullit austro-hungarez, i cili kishte vlerësuar se në Shqipëri kishin filluar aksione për organizimin e një kryengritje.<sup>195</sup> Madje këtë

---

<sup>193</sup> AIHT, Vj-22-11-1104, Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar MPJ në Vjenë, më 8 shkurt 1912.

<sup>194</sup> Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, *Veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës (dokumente)*, Përzgjedhjen dhe redaktimin: Skender Asani, Mehmet Prishtina, Sefer Tahiri, Shkup, 2012, f. 49; Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare (1911-1912)*, Libri 2, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2004, f. 137.

<sup>195</sup> AIHT, Vj-22-2-235, Raport sekret i konsullit austro-hungarez në Selanik dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, 31 janar 1912.

mbështetje e kishte konfirmuar edhe kabineti i Vjenës.<sup>196</sup> Përkrahja verbale që Hasan Prishtina mori nga diplomacia austro-hungareze e inkurajoi atë që në seancën e radhës të Parlamentit osman, më 11 janar 1912 para deputetëve dhe Qeverisë osmane, të mbante fjalimin e famshëm, që njihet si deklaram dhe fillim i kryengritjes antiosmane për të drejta autonome kombëtare, për të kaluar më pas tek “Komploti i Taksimit”, i cili e zyrtarizoi këtë kryengritje në rrethe të elitës kombëtare shqiptare.<sup>197</sup>

Meqenëse organizimi i një lufte të armatosur kundër Perandorisë Osmane, administratës së saj dhe ushtrisë që ishte e vendosur në vilajetet shqiptare, kërkonte një masë të nevojshme dhe konsiderueshme armësh, atëherë krerët shqiptarë të Vilajetit të Kosovës, duke qenë drejtues të popullit vendosën që të siguronin sasi të mjaftueshme armësh për të shpërthyer kryengritjen. Ndonëse në popull akoma nuk ishin bërë të njohura detajet e një kryengritjeje të përgjithshme, që në muajt e parë të vitit 1912 qindra shqiptarë të viseve të Gjilanit dhe rrethinës ishin paraqitur para organeve të pushtetit lokal dhe iu kishin drejtuar atyre me kërkesën për rikthimin e armëve të rrëmbyera pas shuarjes së kryengritjes së vitit 1910. Rreziku i jashtëm ishte arsyeja kryesore me të cilën ata i arsyetonin kërkesat e tyre para pushtetit lokal. Fluksi i të interesuarve për t'u pajisur me armë ishte mjaft i madh, sa që numri i atyre që ishin regjistruar për këtë çështje kishte arritur deri në 1000 shqiptarë. Me sa duket, kërkesa e tyre nuk kishte gjetur mbështetje, pasi që krerët e Lëvizjes Kombëtare në Gjilan dhe rrethinë në muajin shkurt kishin ndërmarrë një aksion në depon e armëve dhe kishin rrëmbyer një sasi të tyre.<sup>198</sup> Për sigurimin e armëve drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare

---

<sup>196</sup> AIHT, Vj-22-6-609, Urdhër rezervat drejtuar konsullit të përgjithshëm në Selanik dërguar MPJ në Vjenë, 25 janar 1912.

<sup>197</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, *Hasan Prishtina (Përmbledhje dokumentesh) 1908-1934*, Përgatitur nga Kujtim Nuro dhe Nezir Bato, “8 Nëntori”, Tiranë, 1982, f. 51-55; Hasan Prishtina, *Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912*, Rrokullia, Prishtinë, 2009, f. 7-12.

<sup>198</sup> Naim Halimi, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në trevën e Karadakut (1908-1912)*, Kumanovë, 2001, f. 224-225.

kishin parë të arsyeshme të hynin në bisedime edhe me përfaqësuesin konsullor të Serbisë në Prishtinë Millojeviq, madje të shkonin edhe vetë në Serbi. Kështu, në shkurt të vitit 1912 vëllai dhe nipi i Idriz Seferit, në marrëveshje me gjeneral Bozha Jankoviqin, kryetar i organizatës “Narodna Odbrana” (“Mbrotjtja Popullore”), kishin dalë në Ristovac.<sup>199</sup> Për këtë çështje më vonë ishin angazhuar edhe Idriz Seferi, Sali Aga dhe krerë të tjerë të kazasë së Gjilanit.<sup>200</sup> Qeveria e Beogradit kishte për qëllim të përvetësonte krerët më me ndikim në Vilajetin e Kosovës, ndër ta edhe Idriz Seferin.<sup>201</sup>

Për situatën mjaft të nderë në viset shqiptare gjatë kësaj kohe shkruanin edhe përfaqësuesit shpirtëror. Lazër Mjeda, arqipeshkv i Shkupit, shkruante në fillim të marsit 1912 se përveç qyteteve, qetësi diku tjetër nuk kishte, pasi që shqiptarë myslimanë dhe të krishterë kishin filluar veprimet e para kryengritëse, duke vrarë ushtarët dhe rrëmbyer plaçkën.<sup>202</sup> Përgatitjet për fillimin e kryengritjes kishin filluar, ndërsa në Gjilan kishin nisur të mbaheshin mbledhje të fshehta në të cilat diskutohej dhe vendosej për organizimin e kryengritjes kundërosmane fillimisht përmes çetave të vogla.<sup>203</sup> Këto mbledhje kishin rezultuar të suksesshme në formimin e këtyre çetave kryengritëse.<sup>204</sup> Për këtë çështje, me qëllim sensibilizimin e popullsisë shqiptare nëpër fshatrat e kazasë së Gjilanit ishin angazhuar lajmëtarë, të cilët me gjithë vështirësitë e paraqitura kishin arritur në masë që të qartësonin qëllimin e kryengritjes. Dhe, si rezultat i kësaj ndërmarrjeje, kishte rezultuar që gjatë pranverës të shënohen disa konflikte në Gjilan dhe rrethinë ndërmjet shqiptarëve dhe autoriteteve lokale (Marec, Lubishtë etj.).<sup>205</sup>

---

<sup>199</sup> Z. Cana, *vep. e cit.*, f. 209.

<sup>200</sup> N. Halimi, *vep. e cit.*, f. 225.

<sup>201</sup> *Dokumente italiane për LK gjatë gjysmës së parë...*, f. 280.

<sup>202</sup> Nevila Nika, *Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare (1910-1912)*, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2003, f. 203.

<sup>203</sup> *Dokumente serbe...*, f. 148 dhe 165.

<sup>204</sup> Po aty, f. 181.

<sup>205</sup> A. Selmani, *vep. e cit.*, f. 216-217.

Ndonëse veprimet e para kryengritëse nisën në trevat perëndimore të Vilajetit të Kosovës apo Rrafshin e Dukagjinit,<sup>206</sup> në Gjilan kishin filluar të mbaheshin takime të fshehta në të cilat diskutohej dhe vendosej për mënyrën e përfshirjes së kësaj ane dhe ndihmën që ajo do të mund të jepte në zonën e kryengritjes. Kështu, në raportin e datës 11 maj të vitit 1912 të konsullit serb në Prishtinë, Millojeviq, dërguar Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Serbisë në Beograd, ndër të tjerash thuhej: “Një çetë prej 30 shqiptarësh të kazasë së Gjilanit kaloi Kosovën (është fjala për Rrafshin e Kosovës, F. R.) në rrugë për Pejë. Konsiderohet se u ka shkuar në ndihmë shqiptarëve”. Ndërkaq në raportin e datës 13 maj nga i njëjti konsull, ndër të tjerash raportohej: “Pohohet... e sigurt që shumë çeta të... Gjilanit kaluan në nahijen (duhet të jetë sanxhakun ose kazanë, F. R.) e Pejës”. Përpos kësaj në raportin e datës 16 maj të vitit 1912 ky konsull shkruante se: “Në mesin e kryengritësve të Pejës gjenden çetat e rrethinës së Gjilanit, Prishtinës dhe Vushtrrisë si dhe të Llapit. Pohohet se ka çeta madje nga Kelmendi dhe Kastrati. Me sa duket lufta e Gjakovës dhe e Pejës mori përmasa më të mëdha se sa e pranojnë këtë qarqet zyrtare”.<sup>207</sup> Këto çeta qëndruan atje gjatë gjithë kohës sa u zhvillua kryengritja.<sup>208</sup>

Situata përgjithësisht e tensionuar, që kishte kapluar Vilajetin e Kosovës, po tregonte sinjalin se shqiptarët tashmë kishin vendosur për një kryengritje me përmasa mbarëkombëtare dhe jo sikur ato të mëparshmet, prandaj ky karakter kishte ndikuar në mobilizimin e gjithë udhëheqësve shqiptarë. Kështu, mbi dyzetë krerë nga rrethet e Drenicës, Gjilanit, Llapit e viseve të tjera, po prisnin shenjën e kryengritjes në Boletin nga Isa Boletini (gjysma e parë majit 1912).<sup>209</sup> Ndërkaq në gjysmën e dytë të majit (21 maj 1912) Idriz Seferi me bashkëluftëtarët e

---

<sup>206</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti i Historisë (grup autorësh), *Historia e Popullit Shqiptar II – Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek. XIX-1912*, Tiranë, 2002, f. 468-469.

<sup>207</sup> *Dokumente serbe...*, f. 170-174.

<sup>208</sup> Po aty, f. 192.

<sup>209</sup> Po aty, f. 183.

tij, pasi që kishte braktisur Gjilanin, iu kishte bashkuar forcave kryengritëse të drejtuara nga Isa Boletini në Drenicë.<sup>210</sup> Bajraktarët e Gjilanit, kohë pas kohe po qëndronin në Boletin tek Isa Boletini.<sup>211</sup> Më së tepërmi në këtë drejtim, nga radhët e gjilanasve, shquhej Idriz Seferi.<sup>212</sup>

Për të bashkërenduar forcat kryengritëse dhe për të hartuar një program kërkesash, realizimi i të cilit do t'i drejtohej Portës së Lartë, u ndje e nevojshme thirrja e një kuvendi ku do të mblidheshin krerë e drejtues të kryengritjes. Kështu, nga 21-25 maj 1912 në Junik u mbajt një Kuvend, në të cilin fjalën kryesore e kishin: Hasan Prishtina, Riza bej Gjakova, Jashar Pasha, Hasan Feri, Isa Boletini etj.<sup>213</sup> Lidhur me rrjedhën dhe rezultatin e punimeve të Kuvendit të Junikut, shqiptarët e kazasë së Gjilanit dhe sanxhakut të Shkupit deklaroheshin telegrafisht se i pranonin paraprakisht të gjitha vendimet që do të dilnin nga punimet e këtij Kuvendi.<sup>214</sup> Pohimin se në këtë Kuvend mori pjesë edhe Idriz Seferi,<sup>215</sup> në bazë të dokumentacionit të hulumtuar dhe shfrytëzuar, nuk kemi arritur ta vërtetojmë. Në Kuvendin e Junikut ishte vendosur që perspektiva e kryengritjes të përhapet në pjesën tjetër të viseve shqiptare deri sa të fitohet autonomia e Shqipërisë.<sup>216</sup> Pas përfundimit të këtij

---

<sup>210</sup> R. Abdyli, *vep. e cit.*, f. 234.

<sup>211</sup> AIHT, Vj-22-20-2095, Raport i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë dërguar ambasadës së Austro-Hungarisë në Stamboll, 18 qershor 1912.

<sup>212</sup> AIHT, Vj-22-10-1027, Raport i ambasadës austro-hungareze në Stamboll dërguar MPJ në Vjenë, 24 qershor 1912.

<sup>213</sup> R. Abdyli, *vep. e cit.*, f. 236-237.

<sup>214</sup> *Dokumente serbe...*, f. 256.

<sup>215</sup> Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, fondi: Gazetat dhe revistat, Sadullah Brestovci, *Idriz Seferi – kreshniku i Karadakut*, fejtton, “Rilindja”, Prishtinë, 26.1.1970, f. 9.

<sup>216</sup> AIHT, Vj-22-5-581, Telegram i konsullit austro-hungarez në Prizren dërguar MPJ në Vjenë, 22 maj 1912.

Kuvendi iu dërgua promemorie Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha për t'i njohur Shqipërisë të drejtat e një province autonome.<sup>217</sup>

Edhe pse Kuvendi i Junikut kishte vendosur për zgjerimin gjeografik të veprimeve kryengritëse, në kazanë e Gjilanit akoma nuk kishte ndodhur një gjë e tillë në mënyrë të hapur, por që situata ishte relativisht e qetë dhe për çdo moment pritej të shpërthente kryengritja.<sup>218</sup> Duhet vënë në konsideratë për këtë çështje edhe qëndrimin destruktiv të elementëve turkomanë shqiptarë.<sup>219</sup> Mirëpo, ishte ndërë nevoja e furnizimit të kryengritësve me armë, pasi që interesimi i po shtohet, prandaj ata po përgatiteshin të sulmonin depot e barotit në qytetet e Gjilanit, Prishtinës, Ferizajt, Gjakovës, Vushtrrisë, etj. Për këtë arsye pushteti osman urdhëroi forcimin e rojeve në depot e armëve, por edhe nëpër rrugët e qyteteve.<sup>220</sup>

### **Shpërthimi i kryengritjes në zonën e Gjilanit**

Edhe pse përfaqësuesit e pushtetit osman bënë përpjekje që trevat lindore shqiptare, përfshirë këtu edhe rrethinën e Gjilanit, ta mbanin të ngujuar nga kontaktet me zonat tjera kryengritëse, prapëseprapë nuk u arrit ndonjë sukses i qëndrueshëm. Drejtuesit popullorë të Lëvizjes Kombëtare të këtyre viseve në krye me Idriz Seferin, Bejtullah Agën, Sali Agën etj., nga kontaktet e vazhdueshme që patën me krerët kryesorë të kryengritjes dhe natyrisht nga nxitja e tyre, u inkurajuan që flakën e kryengritjes ta përcillnin edhe në këto anë.

---

<sup>217</sup> N. Nika, *vep. e cit.*, f. 223; Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë & Instituti i Historisë, *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878-1912)*, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë, 1978, f. 240.

<sup>218</sup> *Dokumente serbe...*, f. 225.

<sup>219</sup> Maliq Osi, *Qëndrimi i parisë turkomanë ndaj vendimeve të Junikut dhe të kryengritjes së përgjithshme shqiptare të vitit 1912*, "Jehona", nr. 7/1977, viti XV, OBP "Nova Makedonija", Shkup, 1977, f. 879-890.

<sup>220</sup> *Dokumente serbe...*, f. 218.

Angazhimi i krerëve gjilanas për sensibilizimin e kryengritjes ndonëse nuk kishte arritur në nivel të dëshiruar, ata, në krye me Idriz Seferin, me atë masë kryengritësish, po përgatiteshin për të sulmuar Kaçanikun.<sup>221</sup> Nuk përjashtohet mundësia që veprimtaria e tij të përcillej në çdo hap nga ana e autoriteteve lokale ose agjentëve të tyre, e në raste të ndryshme edhe të pengohej. Konsulli austro-hungarez në Shkup, Heimroth, e konsideronte si revolucionar aktivitetin e Idriz Seferit për të propaganduar lëvizjen kryengritëse në këto anë dhe zënien e Grykës së Kaçanikut. Për këtë çështje, Idriz Seferi kishte arritur të manipulonte me autoritetet osmane në Gjilan, që të shkonte në Junik për gjoja “shërbimin informativ”, por i kishte gënjyer ato dhe se ishte bashkuar me kryengritësit në Rrafshin e Dukagjinit. “Në shtëpinë e Seferit (është fjala për Idriz Seferin, F. R.) – shkruan ky konsull – më pas u bënë përkuzime (kontrollime, F. R.) që nuk dhanë rezultat”.<sup>222</sup>

Ideja e vënies në dorë të qytetit dhe Grykës së Kaçanikut kishte të bënte me strategjinë luftarake të Idriz Seferit për të bllokuar depërtimin e forcave osmane në drejtim të viseve të tjera të Vilajetit të Kosovës. Prandaj, kur të arrihej bllokimi dhe marrja e kësaj gryke, çlirimi i qyteteve të tjera të Vilajetit të Kosovës, përfshi këtu edhe qytetin e Gjilanit, do të ishte më i lehtë. Për këtë çështje ai po interesohej që të çonte në këmbë tërë sanxhakun e Prishtinës.<sup>223</sup> Kjo përpjekje e krerëve të Lëvizjes Kombëtare në rrethinën e Gjilanit dhe më gjerë në Vilajetin e Kosovës, i kishte rënë në sy të keq pushtetit osman, i cili ishte mjaft i shqetësuar<sup>224</sup> për çka kishte vendosur të kapte ata dhe kështu të paralizonte depërtimin e frymës kryengritëse në këto anë, mirëpo një tentativë e tillë nuk kishte arritur të rezultojë e suksesshme. Për këtë çështje, konsulli serb në Prishtinë, më 24 qershor 1912 mes të tjerash i

---

<sup>221</sup> Po aty, f. 263.

<sup>222</sup> AIHT, Vj-22-20-2033, Infomacion i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar ambasadës së Austro-Hungarisë në Stamboll, 11 qershor 1912.

<sup>223</sup> *Dokumente franceze I...*, f. 140.

<sup>224</sup> AIHT, Vj-22-20-2091-2092, Raport i nënkonsullit austro-hungarez në Mitrovicë dërguar ambasadës së Austro-Hungarisë në Stamboll, 11 korrik 1912.

raportonte Beogradit: “Në tërë Arnautllëkun (Shqipërinë, F. R.) ndihet një qetësi e vogël. Pushuan përleshjet më të mëdha ndërmjet ushtrisë dhe kryengritësve. Megjithatë, krerët shqiptarë veprojnë edhe më tutje në të gjitha viset kundër regjimit të turqve të rinj. Në kazanë e Gjilanit, agjitacion të madh kundër regjimit ekzistues zhvilluan përsëri këta krerë shqiptarë: Idriz Seferi, Kasem Seferi, Emin Bllaca dhe Sali aga. Në fillim të këtij muaji kundër tyre u dërgua patrulla e madhe e ndjekjes e ngarkuar me detyrë që t’i kap dhe tua dorëzoj pushtetit. Posa shqiptarët morën vesh për këtë ndjekje ushtarake, e vranë fill nëpunësin policor (mydyrin) të nahijes së Kazasë së Gjilanit në Hogosht. Shqiptarët në të njëjtën kohë formuan çetat me nga 20-30 njerëz për t’i bërë ballë ushtrisë”.<sup>225</sup> Përveç vrasjes së mydyrit ishin plagosur edhe dy xhandarë.<sup>226</sup> Ndër shkaqet që çuan në vrasjen e mydyrit të Hogoshtit kishin të bënin me përndjekjet dhe kontrollin e ashpër të autoriteteve osmane ndaj veprimtarisë atdhetare shqiptare në Moravën e Poshtme. Vrasja kishte ndodhur pasi mydyri po kthehej nga Gjilani në Hogosht, ndërsa grupi që vrau atë përbëhej nga Ibrahim Zhuja, Islam Zuka nga Desivojca, Emin Bllata<sup>227</sup> dhe Sali Aga nga Gjilani. Të njëjtën gjë ndaj veprimtarëve të Lëvizjes Kombëtare në këto anë e kishte bërë edhe mydyri pasardhës, por ai për të shpëtuar fatin e tij, u detyrua me të shpejtë të largohej së bashku me qatipin (zyrtar osman që merrej me hartimin dhe shkrimin e shkresave, F. R.) dhe xhandarët për në Gjilan dhe nga aty drejt Prishtinës.<sup>228</sup> Ngjarja e Hogoshtit i kishte dhënë hov lëvizjes kryengritëse në kazanë e Gjilanit dhe kështu, në fund të këtij muaji e posaçërisht në fillim të muajit korrik 1912, do të shpinte këto treva në mesin e zonave kryengritëse. Në nxitjen e kësaj vale kishte reflektuar edhe qëndrimi i herëpashershëm i Isa Boletinit në këtë kaza,

---

<sup>225</sup> *Dokumente serbe...*, f. 311; Ramiz Abdyli, *Shtypi bullgar mbi Kryengritjen e Përgjithshme Shqiptare të vitit 1912*, “Gjurmime albanologjike” – seria e shkencave historike, nr. 25-1995, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997, f. 126.

<sup>226</sup> *Dokumente franceze I...*, f. 154.

<sup>227</sup> Sadulla Brestovci, *Lëvizja Kombëtare në Kazanë e Gjilanit – Islam Pira (1861-1931)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008, f. 149.

<sup>228</sup> A. Selmani, *vep. e cit.*, f. 229-230.

ku gjatë fundit të qershorit dhe fillimit të korrikut ishte takuar me krerët e Lëvizjes Kombëtare të këtyre viseve si Idriz Seferi e Sali Aga. Me këtë rast bëhej edhe shpërndarja e armëve për kryengritësit.<sup>229</sup>

Situata në Gjilan dhe rrethinë shkallë-shkallë kishte filluar të bëhej mjaft serioze dhe e vështirë për t'u kontrolluar. Si rezultat i kësaj paqëndrueshmërie, me gjithë urdhrat e komandantit të Ferizajt, batalionet ushtarake osmane refuzonin për të shkuar atje dhe të luftonin kundër kryengritësve,<sup>230</sup> që nënkuptonte një lidhje dhe sinkronizim mes oficerëve shqiptarë që shërbenin në ushtrinë osmane dhe kryengritësve.<sup>231</sup> Mirëpo, me sa duket edhe vizitat e kohëpaskohshme të valiut të Kosovës, Mas`har Beu, ndonëse përkohësisht, nuk kishin ndikuar që të bindnin krerët e rrethinës së Gjilanit që të mos vazhdonin zgjerimin e kryengritjes, të rihapnin pazarin e qytetit, apo edhe të sulmonin qytetet përreth.<sup>232</sup> Meqenëse autoritetet osmane ishin të alarmuara për një lëvizje të kryengritësve të kësaj ane në drejtim të Kaçanikut, ato ishin detyruar të dërgonin forca ushtarake nga Kumanova<sup>233</sup> për të përforcuar garnizonin në Grykën e Kaçanikut dhe kështu për të penguar marrjen e saj nga ana e shqiptarëve të këtyre trevave.<sup>234</sup> Prandaj, për të qetësuar situatën në kazatë e Gjilanit dhe

---

<sup>229</sup> *Dokumente franceze I...*, f. 190; R. Abdyli, *vep. e cit.*, f. 296-297.

<sup>230</sup> *Dokumente serbe...*, f. 354.

<sup>231</sup> Eqrem bej Vlora, *Kujtime (1885-1925)*, Përktheu nga gjermanishtja: Afrim Koçi, IDK-botim i tretë, Tiranë, 2012, f. 265; *Udhëtime nëpër Ballkan (Kujtime nga jeta e Franc Baron Nopça)*, Pajisur me parathënie, shtojcë dhe përgatitur nga Robert Elsie, përktheu: Ilirjana Angoni, Plejad, Tiranë, 2007, f. 358; Ramiz Abdyli, *Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912 dhe lëvizja e oficerëve*, "Kosova" 24/25 2002/2003, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2003, f. 85-116; Stavro Skendi, *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912*, përkthyer nga Skënder Luarasi & Nestor Nepravishta, Phoenix & ShBLU, Tiranë, 2000, f. 385.

<sup>232</sup> AIHT, Vj-22-1-131 & Vj-22-20-2090, Raporte të konsullit dhe nënkonsullit austro-hungarez në Mitrovicë dërguar MPJ në Vjenë dhe ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll, 18 korrik 1912; *Dokumente serbe...*, f. 360, 370 dhe 376.

<sup>233</sup> *Dokumente serbe...*, f. 363; *Dokumente ruse për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare më 1912* (në tekstin e mëtejme: *Dokumente ruse...*), hulumtuan, përzgjedhën dhe përgatitën: Prof. dr. Muhamet Shatri dhe Prof. dr. Ramiz Abdyli, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2006, f. 147.

<sup>234</sup> *Dokumente serbe...*, f. 364.

Preshevës ishin dërguar disa bateri artilerie nga Shkupi në drejtim të Kumanovës.<sup>235</sup> Tani, kërcënimet e shqiptarëve drejtuar kajmekamit të Gjilanit, valiut të Kosovës e përfaqësuesve të tjerë të administratës osmane, ishin bërë përditshmëri. Konsulli austro-hungarez në Shkup, Heimroth, në një relacion drejtuar Palavicinit, ambasadorit austro-hungarez në Stamboll, shkruante se rreth 2000 shqiptarë ishin mbledhur në Novosellë të Gjilanit, nën drejtimin e Idriz Seferit, gjë që e kishte shtyrë komandantin e xhandarmërisë të kërkonte përforcime ushtarake, me ç'rast u dërgua një bateri drejt këtij territori. Megjithëkëtë, ky konsull vlerësonte se gjendja e sigurisë në kaza të Gjilanit ishte mjaft e keqe dhe se vrasje po shënoheshin çdo ditë.<sup>236</sup> Mirëpo, kjo lëvizje e forcave osmane nuk i frikësonte krerët e kësaj ane dhe vullnetarët e tyre që të merrnin pjesë në çdo përpjekje të kryengritësve, posaçërisht në sanxhakun e Prishtinës.

Në luftimet e zhvilluara ndërmjet forcave kryengritëse dhe ushtrisë osmane në Prishtinë (12 korrik 1912), kolona e Prishtinës kishte pësuar humbje të rënda, sepse në dalje të qytetit kishte hasur në rezistencë të kryengritësve. Konsulli rus në Mitrovicë, Llobaçev, dëshmitar i këtyre luftimeve, e njoftonte Shën Petërburgun se "...oshtima e batave dhe e rrahjes me artileri dëgjohej brenda në qytet nga ora e mesnatës deri në mëngjes dhe, nëse në këtë kohë do të kishte ardhur Idriz Seferi me shqiptarët nga Gjilani, Prishtina do të kishte rënë në duart e kryengritësve, sepse gjendja e trupave (osmane, F. R.) ishte fare e rënë, kurse njëri batalion nuk pranoi të bindej dhe u desh të bëhej çarmatosja në vetë qytetin". Pas këtyre luftimeve popullsia shqiptare e Prishtinës u bashkua hapur me kryengritësit, të cilët tani po zotëronin situatën. Në anën tjetër, Idriz Seferi po i organizohej një pritë nga ana e trupave osmane me një bateri fushore prej anës së Gjilanit në malin Kravarica, sikurse edhe nga ana e Drenicës pranë Goleshit. Ditën e nesërme, vali u

---

<sup>235</sup> *Dokumente franceze I...*, f. 194.

<sup>236</sup> AIHT, Vj-22-20-2031, Relacion i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll, 12 korrik 1912.

Kosovës, Maz`har Beu kishte ardhur në Prishtinë nga Gjilani, në të cilin situata ishte shumë e keqe.<sup>237</sup> Në një gjendje të tillë mjaft të tensionuar dhe komplekse, pjesëtarët e ushtrisë osmane kishin nisur të dyshonin në suksesin e tyre, madje ky dyshim u shtua sidomos tek ushtarët dhe oficerët shqiptarë që shërbenin në ushtrinë osmane, aq më shumë kur ata nuk dëshironin të luftonin kundër vëllezërve të tyre.<sup>238</sup>

Shqiptarët e sanxhakut të Prishtinës e kishin shprehur solidaritetin e tyre me kryengritësit. Po bëheshin përgatitje për sulme më të fuqishme dhe më të shtuara në kuptimin e numrit të kryengritësve. Kështu, Sali Aga nga Gjilani, së bashku me disa krerë të tjerë të kryengritjes, me 600 burra ishte nisur drejt Prishtinës, kurse në afërsi të Gjilanit ndodhej Dan Rusinovci me 700 vullnetarë. Idriz Seferi kishte arritur të grumbullonte rreth tij mbi 500 njerëz dhe se veprimet do t'i koordinonte në bashkëpunim me Bejtullah Beun nga Gjilani.<sup>239</sup> Kjo situatë e brishtë kishte ndikuar që në Gjilan të vazhdonte të mbetej i mbyllur pazari i qytetit, ndërsa ushtria osmane, me të qenë në dijeni se kryengritësit e Gjilanit dhe rrethinës kishin për cak sulmin në Grykë të Kaçanikut, reparti ushtarak osman në Grykë u përforcua me një batalion nga Dedeagaçi.<sup>240</sup> Për më tej u vështirësua mjaft gjendja administrative, revolta e shqiptarëve mori karakter masiv dhe u shtua motivi në arritjen e qëllimeve të kryengritjes, faktorë këta që kishin ndikuar tek krerët e Lëvizjes Kombëtare të ndërronin në vazhdimësi raportin e tyre me drejtuesit qeveritar të kazasë. Kështu, Sali Aga i Hogoshtit, që në të njëjtën kohë ishte dhe organizator dhe përçues i masave kryengritëse në pjesën veriore të kazasë, përmes një letre e kishte kërcënuar kajmekamin e Gjilanit, gjë që kishte ndikuar në braktisjen e detyrës së këtij të fundit

---

<sup>237</sup> AIHT, Vj-22-3-351, Raport i atasheut ushtarak të Austro-Hungarisë në Stamboll dërguar shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë austro-hungareze, 25 korrik 1912; *Dokumente ruse...*, f. 159-160.

<sup>238</sup> R. Abdyli, *pun. i cit.*, f. 85-116.

<sup>239</sup> *Dokumente serbe...*, f. 373.

<sup>240</sup> AIHT, Vj-22-13-1390, 22-13-1388, Telegramme të konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar MPJ në Vjenë, 20, 22 dhe 23 korrik 1912; *Dokumente serbe...*, f. 381.

dhe vendimin për të ikur në Shkup. Pakënaqësia ndaj pushtetit osman kishte ndikuar që ai të gjuhej nga shqiptarët, por i kishte shpëtuar vdekjes. Megjithatë, autoritetet osmane ishin të vendosura që kazanë e Gjilanit ta mbanin akoma nën vëzhgimin e tyre sidomos kur emëruan në postin e kajmekamit Xhelal Beun, kajmekam i Kumanovës. Valiu i Kosovës po vazhdonte përpjekjet dhe kërkesat drejt kryengritësve që ata të shpërndareshin, por një tentativë e tillë nuk gjente miratimin e tyre. Në këtë kontekst, meqë përfshirja e kazasë së Gjilanit në kryengritje kishte dhënë prova të një organizimi të mirë, duke gjetur shtrirje në gjithë territorin e saj, Idriz Seferi si përfaqësues i Karadakut të Shkupit, Ahmet Aga si përfaqësues i pjesës jugore të kazasë dhe Bejtullah Aga si përfaqësues i pjesës veriore, përmes një telegrami kërkuan nga dy deputetë shqiptarë në parlamentin osman të gjenin mënyra efektive për qetësimin e mëse 80 mijë shqiptarëve të këtyre viseve për realizimin e të drejtave të natyrshme, kërkesë e cila do t'i paraqitej parlamentit dhe senatit osman në seancat e ardhshme.<sup>241</sup> Me qëllim të shtonin numrin e forcave kryengritëse dhe të rritnin epërsinë në raport me qëllimin e kryengritjes, shqiptarët e kazasë së Gjilanit kërkonin lirin e robërve të burgosur.<sup>242</sup>

### **Çlirimi i qytetit të Gjilanit dhe bisedimet me Komisionin Qeveritar**

Muajin korrik, në raport me organizimin dhe çështjen e sensibilizimit të banorëve të kazasë së Gjilanit, për t'iu bashkuar radhëve të kryengritësve, ishte në nivel të lartë. Kështu, një çetë prej 15 vetash kishte marrë përsipër që të vizitonte çdo fshat për t'u bërë thirrje shqiptarëve për revoltë masive.<sup>243</sup> I angazhuar në këtë drejtim ishte edhe udhëheqësi kryesor në këto anë, Idriz Seferi, i cili po drejtonte

---

<sup>241</sup> AIHT, Vj-22-20-2028, Raport i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll, 19 korrik 1912.

<sup>242</sup> AIHT, Vj-22-2-203, Telegram i konsullit austro-hungarez në Selanik drejtuar MPJ në Vjenë, 26 korrik 1912.

<sup>243</sup> *Dokumente franceze I...*, f. 198.

tubimet e shpeshta që po mbaheshin në Moravën e Poshtme dhe në Gollak, me qëllimin për t'u përgatitur sa më mirë për një kryengritje të përmasave të gjera.<sup>244</sup> Në mesin e muajit korrik në Gjilan ishin mbledhur krerët e Lëvizjes Kombëtare nga 38 fshatrat e kazasë së bashku me prijësit kryesorë, përveç Idriz Seferit, duke realizuar dy mbledhje.<sup>245</sup>

Tashmë, mes krerëve dhe kryengritësve të trevave lindore, ishin vërejtur edhe elemente bashkëpunimi dhe bashkërendimi të aksioneve rreth planifikimit dhe mënyrës së organizimit të sulmeve kundër forcave osmane. Kështu, më 21 korrik 1912, duke iu bashkuar forcave të tjera kryengritëse, Idriz Seferi së bashku me dy mijë kryengritës marshoi drejt Kaçanikut.<sup>246</sup> Tani, masa e madhe shqiptare kishte arritur të tubohet rreth Prishtinës, ku në mesin e gjithë kryengritësve të të gjitha viseve të Vilajetit të Kosovës ishin nisur edhe 2000 kryengritës të Gjilanit dhe rrethinës nën drejtimin dhe përgatitjen e Idriz Seferit dhe Sali Kupinës, të cilët së bashku me Mehmet Pashë Dërrallën e Tetovës dhe ish deputetin e Shkupit, Sait Hoxhën, kishin për detyrë zënien e Grykës së Kaçanikut.<sup>247</sup>

Në anën tjetër, edhe oficerët ushtarakë osmanë nuk iu bindeshin urdhrave për të luftuar kryengritësit. Situata në Gjilan ishte mjaft e vluar, njëjtë si në Prishtinë dhe tërë sanxhakun. Vazhdonin telegrame protestash e kërcënimesh drejt sulltanit, të cilat kishin ndikuar që qeveria t'i merrte parasysh ato dhe t'i jepte një zgjidhje kërkesave të shqiptarëve. Prandaj flitej për dërgimin e një komisioni qeveritar për të

---

<sup>244</sup> A. Selmani, *vep. e cit.*, f. 235; *Dokumente italiane për Lëvizjen Kombëtare gjatë gjysmës së dytë të vitit 1912*, hulumtuan, përzgjedhën dhe përgatitën: Prof. dr. Ramiz Abdylit dhe Prof. dr. Muhamet Shatri, Arkivi i Kosovës, "VJETAR", nr. XXXI-XXXII, Prishtinë, 2004, f. 226.

<sup>245</sup> Po aty, f. 237.

<sup>246</sup> *Dokumente serbe...*, f. 395.

<sup>247</sup> Po aty, f. 397.

negociuar me kryengritësit.<sup>248</sup> Shqiptarët nga Vilajeti i Manastirit i kishin drejtuar një letër Hasan Prishtinës me kërkesën që të thërrasë telegrafisht delegatët e Shqipërisë së Jugut dhe Shqipërisë së Mesme në bisedimet që do të zhvilloheshin në Prishtinë me komisionin qeveritar, me ç`rast kërkesat do të kishin karakterin gjithëpërfshirës të viseve shqiptare.<sup>249</sup> Këshilli Revolucionar i Shqipërisë së Jugut kishte emëruar telegrafisht delegat Hasan Prishtinën për përfaqësimin e kërkesave të tyre në bisedime me komisionin qeveritar. Arsyet që e shtynë këtë Këshill që t`i besonte këtë kompetencë Hasan Prishtinës, kishin të bënin me dashurinë dhe besnikërinë e madhe që ai kishte provuar ndaj atdheut jo me fjalë, por me vepra dhe sakrifica.<sup>250</sup>

Në anën tjetër, më 23 korrik 1912 ishte zhvilluar një përleshje e armatosur ndërmjet kryengritësve të Shkupit, Gjilanit dhe të Tetovës me forcat e vendosura në Grykën e Kaçanikut. Të nesërmen forcat osmane kishin pësuar disfatë, ndërsa ushtarët e zënë rob, u çarmatosën dhe u liruan.<sup>251</sup> Për më tepër, kryengritësit e kazasë së Gjilanit përmes të dërguarve të tyre kishin njoftuar fshatrat e Karadakut të Shkupit për të përgatitur sasi të mjaftueshme ushqimi,<sup>252</sup> që tregonte planet e tyre për t`u nisur në drejtim të Shkupit. Po ashtu, në këtë ditë, krerët kryengritës të kazasë së Gjilanit, me përfaqësues Idriz Seferin e Bejtullah Agën, së bashku me krerët kryengritës të kazasë së Tetovës dhe Shkupit, Mehmet Pashë Derrallën dhe Sait Idriz Hoxhën, kishin mbajtur një mbledhje në Pozheran, me ç`rast ishte vendosur të sulmohej edhe qyteti i Gjilanit.<sup>253</sup> Ndërkaq, pas 5 ditësh u mbajt një mbledhje tjetër në Pozheran, ku morën

---

<sup>248</sup> AIHT, Vj-22-6-655, Raport i konsullit austro-hungarez në Selanik dërguar MPJ në Vjenë, 20 korrik 1912; *Dokumente franceze I...*, f. 153; *Dokumente serbe...*, f. 384.

<sup>249</sup> AIHT, Vj-22-19-1990, Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir drejtuar MPJ në Vjenë, 30 korrik 1912.

<sup>250</sup> N. Nika, *vep. e cit.*, f. 271.

<sup>251</sup> AIHT, Vj-22-20-2026, Relacion i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar ambasadës së Austro-Hungarisë në Stamboll, 28 korrik 1912; *Dokumente franceze I...*, f. 208; R. Abdyl, *vep. e cit.*, f. 322.

<sup>252</sup> R. Abdyl, *vep. e cit.*, f. 323; "Politika", Beograd, 3041, 7/20, VII. 1912.

<sup>253</sup> Po aty, f. 326.

pjesë Bajram Curri, Riza bej Kryeziu, Idriz Seferi, Menduh Beu dhe krerë të tjerë të kësaj ane dhe ranë në një mendje për vazhdimin e luftës së armatosur deri në realizimin e platformës autonomiste të kryengritjes. Bashkëpunimi mes kryengritësve gjakovarë dhe atyre gjilanas, si edhe më parë, ishte i madh edhe në këtë kryengritje. Jo rastësisht, gjatë kësaj kohe në Gjilan dhe rrethinë po vepronin rreth 800 kryengritës gjakovarë, të sistemuar nëpër fshatrat Ballancë, Mirosalë, Pozheran, Gadime, Komogllavë, Sadovinë, Sllakovc etj., ndërsa Bajram Curri po vizitonte çdo fshat të rrethinës së Gjilanit për sensibilizimin e shqiptarëve për t'iu bashkuar në mënyrë më masive programit të kryengritjes, me ç'rast kishte arritur të grumbullonte rreth tij 1500 kryengritës.<sup>254</sup> Në ndërkohë, pasi që autoriteti i administratës osmane në kaza të Gjilanit ishte i paralizuar, rreth 1500 kryengritës po vepronin në kodrat e Kaçanikut.<sup>255</sup>

Meqenëse kryengritësit në Prishtinë tashmë ishin në kulm të qëndresës, ata, përmes një qarkoreje telegrafike i bënë të njohur qytetet e tjera të Vilajetit të Kosovës për marrjen parasysh të kërkesës dërguar sulltanit për ndërprerjen e kësaj gjakderdhje dhe dërgimin e një komisioni të paanshëm qeveritar për të mësuar më shumë mbi kërkesat e kryengritësve shqiptarë. Në këtë qarkore u kërkohej qyteteve të këtij vilajeti të dërgonin delegatët e tyre në Prishtinë (18 korrik 1912). Kështu, më 24 korrik 1912, në Prishtinë kishin arritur delegatët e Gjilanit, Preshevës, Ferizajt, Shkupit e Tetovës. Në mesin e kryengritësve që po niseshin drejt Prishtinës përmes stacionit hekurudhor Shkup-Prishtinë-Mitrovicë, ishte edhe Idriz Seferi me 1.800 shqiptarë.<sup>256</sup> Në Prishtinë ishin mbledhur 15.000 kryengritës së bashku me krerët e tyre, ndër ta edhe Bejtullah Beu nga Gjilani.<sup>257</sup> Një pjesë e krerëve kryengritës nuk besonte në suksesin e bisedimeve mes shqiptarëve dhe Komisionit

---

<sup>254</sup> N. Halimi, *vep. e cit.*, f. 242.

<sup>255</sup> AIHT, Vj-22-20-2026, Relacion i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll, 28 korrik 1912.

<sup>256</sup> *Dokumente ruse...*, f. 173.

<sup>257</sup> Po aty.

Qeveritar, prandaj nisi të largohet nga Prishtina. Në anën tjetër, me urdhrin qeveritar, 12 batalione të këmbësorisë me një numër të madh topash po afroheshin drejt Kaçanikut dhe Ferizajt, prandaj kryengritësit po largoheshin nga këto anë, duke u vendosur në Moravë dhe Gjilan, territor ky që u shërbente atyre si bazë e kryengritjes dhe strehimit të kryengritësve në këto treva.<sup>258</sup>

Gjatë kësaj kohe, për shkak të përmasave që kishte marrë kjo kryengritje, numri i forcave kryengritëse në kaza të Gjilanit sillej mes 2000-4000 vetë. Ato, më 25 korrik 1912, kishin depërtuar në fshatin Tërnoc të Bujanocit dhe kishin ndikuar që të nesërmen qyteti i Bujanocit të çlirohet nga pushteti dhe administrata osmane.<sup>259</sup> Ndërkohë, rreth 2000 kryengritës nën drejtimin e Idriz Seferit dhe Bejtullah Beut, ishin në pritje të kryengritësve nga Prishtina që kështu të hynin në Gjilan dhe të merrnin të gjitha kazermat dhe burgjet dhe t'i lironin të dënuarit. Pas kësaj, planifikohej që kjo masë e kryengritësve të ndahej në dy grupe, ku njëri prej tyre do t'ia mësynte Shkupit përmes Preshevës, kurse grupi tjetër në krye me Idriz Seferin përmes Kaçanikut do t'ia mësynte Shkupit, që më së shumti do të arrinin atje për tri ditë. Si rezultat i kësaj situatë të vështirë për t'u menaxhuar ishte ndërprerë edhe posta midis Gjilanit dhe Ferizajt, ndërsa kryengritësit nuk po hasnin në rezistencë.<sup>260</sup> Më 26 korrik 1912 kishin arritur në afërsi të Gjilanit 300 kryengritës nga Kriva Reka dhe Morava e Poshtme nën drejtimin e Bjetullah Beut, Sali Agës dhe Ahmet Agës, të cilëve iu kishin bashkuar edhe disa xhandarë. Në mbrëmje ata u futën në qytet pa qenë të rezistuar nga ana e forcave osmane që në përbërje prej 600 vetash ishin mbyllur brenda kazermës ushtarake. Të nesërmen në Gjilan kishte hyrë një grup tjetër kryengritësish prej 500 vetash nga rrethet e Shkupit, Kumanovës dhe Preshevës, që udhëhiqeshin nga Menduh Beu, i biri i Jashar Pashës së Shkupit. Për të shpenzuar sasinë e të hollave të grumbulluara nga shitja

---

<sup>258</sup> Po aty, f. 178.

<sup>259</sup> R. Abdyli, *vep. e cit.*, f. 327.

<sup>260</sup> *Dokumente serbe...*, f. 416 dhe 434.

e çifligut, Menduh Beu i kishte marrë ato me vete për nevoja të kryengritjes. Kështu, në Gjilan tashmë ndodheshin rreth 2000 kryengritës, ndërsa 2000 të tjerë qëndronin në rrethinën e tij.<sup>261</sup> Idriz Seferi, derisa gjatë kësaj kohe po qëndronte jashtë qytetit së bashku me bashkëluftëtarët e tij, u ndesh me forcat osmane të dërguara nga Shkupi dhe Kumanova, të cilat i theu, gjë që i hapi rrugë dominimit të kryengritësve në gjithë kalanë e Gjilanit. Pas kësaj fitoreje, më 28 korrik 1912, ai hyri në Gjilan së bashkë me 2000 kryengritës, të cilët u pritën nga populli në mënyrë madhështore. Atë ditë në Gjilan kishin arritur edhe 250 kryengritës nga Gjakova, në krye me Sulejman Batushën.<sup>262</sup> Në kuadër të kësaj ndërmarrje, bënte pjesë edhe Bajram Curri, i cili, sipas konsullit serb në Prishtinë, Millojeviq, në rast se Shkupi do të sulmohej nga kryengritësit, ai do të nisej për atje përmes Gjilanit dhe Preshevës.<sup>263</sup> Këtë e konfirmon edhe konsulli francez në Shkup P. Karlie më 31 korrik 1912, ku njofton se Gjilani ishte çliruar më 28 korrik 1912.<sup>264</sup>

Çlirimi i Gjilanit kishte ndikuar që autoritetet osmane në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës në Shkup të nxirrnin topat në llogore në pjesën veriperëndimore të Shkupit në drejtim të kazave të Gjilanit dhe të Preshevës.<sup>265</sup> Mirëpo, dezertimet e xhandarëve osmanë në këto anë u shtuan saqë tani më tepër se gjysma e tyre ishte bashkuar me kryengritësit.<sup>266</sup> Meqenëse në Gjilan tashmë ishin përqendruar mijëra kryengritës dhe meqë strehimi i tyre shkaktonte vështirësi dhe se situata e përgjithshme diktonte një qasje serioze të qeverisë për të shqyrtuar kërkesat e kryengritësve, atëherë kryengritësit në këtë anë u këshilluan të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre, por të mos qëndrojnë indiferent në

---

<sup>261</sup> N. Halimi, *vep. e cit.*, f. 238.

<sup>262</sup> "Politika", Beograd, 3052, 18/31. VII. 1912.

<sup>263</sup> *Dokumente serbe...*, f. 428.

<sup>264</sup> *Dokumente franceze I...*, f. 223.

<sup>265</sup> R. Abdyl, *vep. e cit.*, f. 302; "Politika", Beograd, 3061, 27.VII/10.VIII. 1912.

<sup>266</sup> AIHT, Vj-22-84, Relacion i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll, 5 gusht 1912.

rast nevoje për të vazhduar më tej kryengritjen.<sup>267</sup> Mirëpo, ata qëndronin të gatshëm në çdo kohë për t'u nisur drejt Shkupit dhe Preshevës.<sup>268</sup>

Pasi që kishte ardhur komisioni qeveritar për të biseduar me kryengritësit rreth kërkesave të tyre, po përgatiteshin edhe përfaqësuesit e Gjilanit dhe rrethinës për të shkuar në Prishtinë.<sup>269</sup> Duhet të theksohet se në kuadër të komisionit për bisedime me kryengritësit, përveç Sylejman Pashës (senator dhe mytesarif shumëvjeçar i Plevlës) dhe Danish Efendisë (ish vali i Selanikut), bënte pjesë edhe Avni Beu nga Gjilani si anëtar i komisionit të caktuar nga ana e qeverisë.<sup>270</sup> Me t'u çliruar qyteti i Gjilanit më 28 korrik 1912, të nesërmen Idriz Seferi, së bashku me udhëheqës të tjerë të kësaj ane, kishte shkuar në Prishtinë.<sup>271</sup> Duhet të theksojmë se ai kishte përkrahjen e vazhdueshme të shqiptarëve katolikë të kësaj ane.<sup>272</sup> Ai, si përfaqësues i rrethinës së Gjilanit kishte marrë pjesë në bisedimet me anëtarët e Komisionit Qeveritar të cilat kishin filluar më 29 korrik pasdite.<sup>273</sup> Gjatë kohës sa po zhvilloheshin bisedimet mes Komisionit qeveritar të përbërë nga përfaqësues me origjinë shqiptare dhe të kryesuar nga Ibrahim Pasha, derisa ky i fundit kishte nisur fjalën dhe po kritikonte shqiptarët për gjoja dëmin që po i shkaktonin Perandorisë me këtë kryengritje, Idriz Seferi kishte ndërhyrë: "A mos është ky ai i cili e kishte shitur Tripolin?", të cilin Perandoria Osmane e kishte humbur në luftën e saj me Italinë (1911-1912). Kërkesat që iu drejtuan qeverisë osmane përmes komisionit qeveritar nga ana e përfaqësuesve të kryengritësve, kishin të bënin me njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare dhe dhënien e të drejtave

---

<sup>267</sup> A. Selmani, *vep. e cit.*, f. 249.

<sup>268</sup> AIHT, Vj-22-18-1878, Njoftim i përfaqësuesit austro-hungarez në Ferizaj dërguar MPJ në Vjenë, 29 korrik 1912; *Dokumente serbe...*, f. 447.

<sup>269</sup> *Dokumente serbe...*, f. 436.

<sup>270</sup> Po aty, f. 442.

<sup>271</sup> Po aty, f. 447.

<sup>272</sup> *Dokumente italiane për LK gjatë gjysmës së dytë...*, f. 255.

<sup>273</sup> *Dokumente franceze I...*, f. 223.

autonome.<sup>274</sup> Kështu, Idriz Seferi nuk donte negociata me këtë Komision, por kërkonte autonominë e Shqipërisë.<sup>275</sup> Meqenëse bisedimet nuk patën sukses, Idriz Seferi përmes një telegrami nga Prishtina kishte kërkuar prej kryengritësve të kazasë së Gjilanit që të mobilizoheshin dhe armatoseshin me armët që ishin blerë nga Serbia. Ai, së bashku me Menduh Beun u kthyen në Gjilan për të grumbulluar kryengritësit, ndërsa udhëheqës të tjerë të këtyre trevave u nisën me tren për Ferizaj.<sup>276</sup> Idriz Seferi dhe Menduh Beu, me 5000 kryengritës kishin ardhur më 2 gusht në Ferizaj.<sup>277</sup>

### **Pjesëmarrja e gjilanasve në çlirimin e Shkupit**

Meqenëse kërkesa e shqiptarëve për shpërndarjen e menjëhershme të Parlamentit drejtuar Ibrahim Pashës, kryetarit të Komisionit Qeveritar, që në parim përkrahej nga ai, mori përgjigje se kjo do të ndodhte në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, atëherë ata dyshuan në realizimin e kësaj kërkesë dhe vendosën të mbanin një Kuvend në Prishtinë. Më 2 gusht 1912 u mbledh një kuvend në Prishtinë në kopshtin e Xhemajl Beut. Kuvendi drejtohej nga Mehmet pashë Derralla. Aty morën pjesë 165 veta, prej të cilëve 125 ishin personalitete me autoritet nga qytetet dhe fshatrat e mëdha, 20 oficerë dhe 20 krerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Pas diskutimeve u arrit në një mendje që të rikërkohet shpërndarja sa më e shpejtë e Parlamentit dhe për këtë Komisionit Qeveritar t'i jepej afat përgjigjeje deri në mëngjesin e 4 gushtit. Në rast të kundërt, shqiptarët do të marshonin drejt Shkupit përmes Moravës së Gjilanit, Kaçanikut dhe Dibrës. Meqë shqiptarët nuk

---

<sup>274</sup> N. Nika, *vep. e cit.*, f. 286-288, 297.

<sup>275</sup> Shukri Rahimi, *Lufta e shqiptarëve për autonomi (1897-1912)*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1978, f. 216.

<sup>276</sup> A. Selmani, *vep. e cit.*, f. 254-256.

<sup>277</sup> N. Halimi, *vep. e cit.*, f. 245.

morën përgjigje deri më 4 gusht 1912, të nesërmen ata u nisën drejt Ferizajt.<sup>278</sup>

Për të ruajtur unitetin mes udhëheqësve të kryengritjes dhe për të hartuar një program kërkesash drejtuar Komisionit Qeveritar, Hasan Prishtina i paraqiti 14 pika Kuvendit të kryengritësve që u mbajt në Ferizaj më 6 gusht 1912. Ky program gjeti miratimin e tij në këtë Kuvend nga përfaqësuesit e kryengritjes. Edhe pse këto kërkesa iu paraqitën Ibrahim Pashës për t'u realizuar brenda tri ditësh, ato u zvarritën nga pala negociuese e Qeverisë.<sup>279</sup> Duke parë që "14 pikat e Hasan Prishtinës" nuk kishin marrë akoma përgjigje, Idriz Seferi së bashku me Isa Boletinin po hartonin planin e fshehtë për çlirimin e Shkupit, plan ky që parashihte depërtimin në Shkup jo përmes Grykës së Kaçanikut ku ishte koncentruar një forcë e konsiderueshme ushtarake osmane, por përmes rrugëve të Kardakut të Gjilanit dhe Karadakut të Shkupit, Preshevës e Kumanovës. Ky plan sigurisht se po shkonte drejt realizimit të tij, pasi që mijëra kryengritës tashmë ishin përqendruar në Gjilan nga i tërë Vilajeti i Kosovës. Për ushqimin e tyre ishin angazhuar 4 furra të qytetit.<sup>280</sup> Kështu, krerët e kryengritësve shqiptarë nga Ferizaj u nisën për në Shkup. Në mesin e kryengritësve ishin edhe ata të rrethinës së Gjilanit.<sup>281</sup> Me porosinë e Idriz Seferit ishin grumbulluar rreth 1000 shqiptarë kryengritës nga kazaja e Preshevës për t'u nisur drejt Shkupit, e nëse do ishte nevoja edhe për ta sulmuar atë.<sup>282</sup> Idriz Seferi ishte në grupin e Bajram Currit, Isa Boletinit e Riza Beut.<sup>283</sup>

---

<sup>278</sup> *Dokumente ruse...*, f. 186.

<sup>279</sup> *Historia e Popullit Shqiptar II...*, f. 489-490; Shaban Hashani, *Ferizaj dhe rrethina 1873-1941*, Ferizaj, 1998, f. 176.

<sup>280</sup> A. Selmani, *vep. e cit.*, f. 258-259; R. Abdylit, *Shtypi...*, f. 134.

<sup>281</sup> *Dokumente serbe...*, f. 503.

<sup>282</sup> Po aty, f. 469.

<sup>283</sup> *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, Vëllimi II, Zgjidhi, përgatiti dhe redaktoi: Prof. dr. Muhamet Shatri, Qendra e Studimeve Albanologjike – Instituti i Historisë-Tiranë, Toena, Tiranë, 2012, f. 97; *Dokumente serbe...*, f. 505.

Një pjesë e kryengritësve të zonës së Gjilanit, me Sali Agën në krye, ndihmoi kryengritësit e kazave të Preshevës dhe Kumanovës që më 16 gusht 1912 në Kumanovë të lirojnë të burgosurit nga burgu i këtij qyteti dhe sikurse në qytete të tjera shqiptare edhe aty të vënë rendin e qetësinë, ndërsa ditën e nesërme shumica e tyre ishin nisur me tren drejt Shkupit.<sup>284</sup> Më 12 gusht, grupi i Karadakut, me Bajram Currin dhe Idriz Seferin në krye, ndaloi në Luboten përkohësisht dhe në dy fshatrat veriore të Shkupit, Bllacë dhe Tanushë, në Karadakun e Shkupit.<sup>285</sup> Konsulli francez në Shkup P. Karlie, konsideronte se Idriz Seferi pritej ta rrethonte Shkupin me një kolonë që do të kalonte nga krahina e Moravës dhe Karadakut përmes fshatrave Bllata (Bllaca, F. R.), Stankovec e Lubanc së bashku me Hasan Prishtinën, Isa Boletinin e Mehmet Pashë Dërralën.<sup>286</sup> Sipas konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, më 14 gusht kishin hyrë në Shkup Riza Beu, Isa Boletini dhe Bajram Curri, të cilët qenë në krye të 3.000 kryengritësve.<sup>287</sup> Ndërkaq në informatën e zëvendëskonsullit britanik në Shkup (15 gusht 1912) brenda dyzetetë orëve të fundit kishin ardhur në Shkup udhëheqësit e kryengritësve, si: Riza Beu, Isa Boletini, Bajram Curri dhe Idriz Seferi.<sup>288</sup> Kryengritësit treguan disiplinë të jashtëzakonshme me rastin e hyrjes së tyre në Shkup dhe gjatë tërë kohës sa qëndruan aty.<sup>289</sup> Sipas konsullit francez në Shkup P. Karlie Hasan Prishtina së bashku me Said Hoxhën kishte arritur në Shkup më 16 gusht 1912.<sup>290</sup>

Në rrethana të tilla, Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare kishte marr fund me marshimin në Shkup. Me ta ishin bashkuar edhe ushtarë osmanë të cilët ishin të veshur në uniforma, por në kokë mbanin kësulën e bardhë shqiptare. Pasi që një fraksion prej kryengritësve synonte të

<sup>284</sup> R. Abdyli, *vep. e cit.*, f. 370-371; A. Selmani, *vep. e cit.*, f. 264.

<sup>285</sup> "Politika", Beograd, 3068, 2/15. VIII. 1912 & 3069, 3/16. VIII. 1912.

<sup>286</sup> *Dokumente franceze I...*, f. 239.

<sup>287</sup> AIHT, Vj-22-3-373, Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar MPJ në Vjenë, 14 gusht 1912.

<sup>288</sup> ITShKShSh, *Veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës...*, f. 78.

<sup>289</sup> E. Vlora, *Kujtime...*, f. 278-282.

<sup>290</sup> *Dokumente franceze I...*, f. 241.

marshojë në Selanik, Ibrahim Pasha, i cili më 17 gusht kishte ardhur në Shkup nga Prishtina, kishte vendosur ta pengonte këtë synim të shqiptarëve, duke kërkuar gatishmëri të forcave osmane që ndodheshin jashtë Shkupit. Ndonëse më 18 gusht ai u kishte bërë thirrje në formë ultimatumit që kryengritësit më 18 gusht brenda 24 orëve të largoheshin nga Shkupi dhe të ktheheshin në vendet e tyre. Kjo gjendje kishte shkaktuar panik tek popullsia e qytetit. Mirëpo, Ibrahim Pasha, si pasojë e përçarjes në kampin shqiptar, ishte i bindur se nuk do të kishte gjakderdhje dhe stafit të huaj diplomatik, që ishte i shqetësuar për sigurimin e shtetasve të tij, i siguroi qetësinë, pasi që Qeveria qendrore kishte vendosur të pranonte kërkesat e shqiptarëve. Tërheqja e shqiptarëve u bë më 20 gusht, ndërsa 24 orë më vonë nuk u pa asnjë kryengritës në qytetin e Shkupit. Ata u larguan të pakënaqur nga Shkupi dhe kërcënuan se pas festës së bajramit do të ktheheshin përsëri në rast se kërkesat e tyre të pranuar nuk do të plotësoheshin deri në atë kohë.<sup>291</sup>

Për sa më sipër, mund të përfundojmë se atdhetarët shqiptarë të rrethinës së Gjilanit në krye me Idriz Seferin dhe drejtues të tjerë të këtyre viseve,<sup>292</sup> u dalluan me pjesëmarrje aktive gjatë tërë kohës sa u zhvillua Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare Kundërosmane. Që nga zgjedhjet e pranverës, me ç'rast në kazanë e Gjilanit u shënuan parregullsi të theksuara nga ana e pushtetit xhonturk, u tregua pakënaqësia e shqiptarëve ndaj këtij regjimi, gjë që paralajmëronte shpërthimin e një kryengritje të armatosur. Në koordinim me udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare, përfshirë edhe Mehmet Pashë Derrallën, krerët gjilanas vazhdimisht bashkëpunuan me drejtues të tjerë

---

<sup>291</sup> AIHT, Vj-22-14-1402, Raport i konsullatës austro-hungareze në Shkup drejtuar MPJ në Vjenë, 8 shtator 1912.

<sup>292</sup> Kasum Seferi, Islam Pira, Hamdi Kurteshi, Zeqë Pira, Fetah Sadovina, Xheladin Guri, Halim Remniku, Ramë Toplana, Musli Velekinca, Bislim Çausi – Begunca, Zejnë Lubishta, Halim Begunca, Murtez Begunca, Emin Brestovci – Muhaxheri, Ramadan Busavata, Mulla Idrizi, Sadik Klaiqi, Jakup Gjakova – Çausi, Fetah Goshica etj. Shih: S. Brestovci, *vep. e cit.*, f. 152-198.

të zonave kryengritëse, i ndihmuan me vullnetarë ato, shfaqën revoltë të hapur ndaj regjimit xhonturk, organizuan mbledhje të fshehta e të hapura për sensibilizimin e shqiptarëve për t'iu bashkuar radhëve të kryengritësve, morën pjesë në çlirimin e qyteteve, kërcënuan dhe luftuan forcat osmane, sidomos në Grykën e Kaçanikut si pikë strategjike për paralizimin e tyre, morën pjesë në bisedimet e zhvilluara me Komisionin Qeveritar, ku përkrahën programin e kryengritjes, e shndërruan Gjilanin me rrethinë në çerdhe për kryengritësit, hartuan planin strategjik dhe morën pjesë në çlirimin e Shkupit. Prandaj, roli dhe kontributi i kësaj treve në Kryengritjen e Përgjithshme Shqiptare Kundërosmane të vitit 1912 është fare i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm.